



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1012/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani e Hunaida Pasuli - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.T. komuna e Vushtrrisë, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B.S. nga Prishtina, kundër të paditurave Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) - Prishtinë dhe Kompania e Sigurimit “S”- Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës së dytë të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1073/14, të datës 20.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **11.11.2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pathemelta ankesa e paditësit B.T. komuna e Vushtrrisë dhe ankesa e të paditurës së dytë Kompania e Sigurimit “S” - Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1073/14, i datës 20.11.2018, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1073/14, të datës 20.11.2018 në pikën *I (një)* të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.T. komuna e Vushtrrisë. Në pikën *II (dy)* të dispozitivit e ka detyruar të paditurën e dytë Kompania e Sigurimit “S” - Prishtinë, që paditësit t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar si pasojë e lëndimit në vendin e punës të datës 01.03.2014, për 70% të përgjegjësisë dhe atë dëmin jo material: për dhimbje fizike të të gjitha intensiteteve, shumën prej 2,150.00€, në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 1,700.00€, dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 3,300.00€. Në pikën *III (tre)* të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit e kërkuar përtej shumës së gjykuar si në pikën II dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike 2,850.00€, në emër të frikës 2,300.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 10,700.00€, për shëmtim shumën prej 2,000.00€. për kujdes nga personi i tretë 200.00€, ushqim të përforcuar 200.00€, dhe në emër të rehabilitimit klimaterik shumën prej 500.00€. Në pikën *IV (katër)* të dispozitivit është detyruar e paditura që për pjesën e

aprovuar të kërkesëpadisë, t'ia paguajë paditësit me kamatë ligjore në lartësi 8%, duke filluar nga data 20.11.2018, dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,229,00€, të gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën V (*pesë*) të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket të paditurës së parë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) – Prishtinë, më gjerësisht si në aktgjykimin e atakuar.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, paditësi ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, duke e aprovuar këtë ankesë të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Poashtu kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, edhe e paditura e dytë ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, duke e aprovuar këtë ankesë të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e paditësit është e pathemeltë.*

- *Ankesa e të paditurës së dytë është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 10.04.2014, në Gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për shkak të kompensimit të dëmit, kundër të paditurave të lartcekura, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit dhe pas shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.1073/14, të datës 20.11.2018, me të cilën pjesërisht e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi ka qenë dhe është në marrëdhënie pune te e paditura e pare në vendin e punës teknik i xehetarisë dhe se me datën 17.03.2014, është lënduar në vendin e punës duke pësuar lëndime të rënda trupore. Në kohën e lëndimit e paditura e parë dhe e paditura e dytë kanë pasur të lidhur kontratën për sigurimin shëndetësor të punëtorëve, që do të thotë se paditësi ka qenë i siguruar tek e paditura e dytë KS "Siguria". Sa i përket bazës ka marrë mendimin e ekspertit për siguri në punë H.N. i cili ka theksuar se përgjegjësia primare i takon punëdhënësit. Gjykata ka gjykuar lartësinë e kompensimit të dëmit duke u bazuar në ekspertizën e ekspertëve mjekësor dr.S.D.- ortoped - traumatolog dhe dr.Sh.H. - psikiatër, sipas të cilave me rastin e aksidentit paditësi ka pësuar thyerje të kokës së radiusit të djathtë. Lëndime të tilla janë konsideruar si lëndime të rënda trupore. Sa i përket

pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit, gjykata ka theksuar se nuk ka pasur prova bindëse me të cilat do të vërtetohet një dëm material më i lartë se sa ai i gjykuar. Poashtu edhe sa i përket për dëmin material të njëjtin e ka refuzuar me arsyetim se nuk ka pasur prova lidhur me të. Gjukata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar duke u mbështetur në nenet 42 të Ligjit të Punës, nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (04/L-077) lidhur me nenin 323 të LPK-së. Për kamatën ka vendosur sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjukata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbartueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjukata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjukata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar.

Gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket pasojave që ka pësuar paditësi për shkak të aksidentit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së eksperteve gjyqësore dr.A.T. - ortoped - traumatolog dhe dr.Sh.H.- psikiatër, i pranon si të tilla edhe Gjukata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Me nenin 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Ndërsa me nenin 137 të këtij ligji parashihet se “*Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkatimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”. . Poashtu në nenin 183 par. 1 të këtij ligji parashihet se “*Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëndetit, të cënimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat*

e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”, ndërsa në par.2 të po këtij neni është paraparë se “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cënimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë se me të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Ndërsa me nenin 2.1 të Ligjit për Siguri në punë, mbrojtje të Shëndetit dhe Ambientit të Punës, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit, është paraparë se **“Punëdhënësi është i obliguar që të sigurojë kushtet për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar për ti mbuluar të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve profesionale.....”**. Ndërsa në nenin 2.10 të po këtij ligji është paraparë se **“Punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar në punë me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjen profesionale që kanë të bëjnë me punën, sipas parimit të përgjegjesisë objektive të së drejtës së detyrimeve”**.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit si dhe shkallën e të mirës nga e cila ai është privuar dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t’i mundësoj të dëmtuarit - këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t’i riparoj në një masë nevojat e tij materiale. Mbi këtë bazë gjykata e shkallës së dytë vlerëson se pretendimet e palës ankuese për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në rastin konkret janë të pabazuara, për çka edhe është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palës paditëse mirëpo ka gjetur se të njëjtat janë të paqëndrueshme për faktin se shumata e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë janë në përputhje me shkallën e të mirës nga e cila është privuar paditësi dhe të njëjtat janë adekuate me shkallën e lëndimeve dhe pasojave të pësuarra në këtë aksident. Edhe sa i përket pretendimit lidhur me çështjen e afatit të ankesës, edhe pse gabimisht gjykata e ka udhëzuar palët për të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditëve (e cila duhet të jetë 15 ditë), mirëpo kjo nuk ka ndikuar në të drejtën e palëve për shfrytëzimin e mjeteve juridike brenda afateve ligjore dhe nuk ka pasur ndikim për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës.

Edhe për kamatën gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur dhe në pajtim me dispozitat e nenit 382 të LMD, duke e gjykuar të njëjtën në lartësinë 8%, e cila është llogaritur nga data 20.11.2018, kur është marrë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e deri në pagesën definitive.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë pa ndikim për ndonjë vendim tjetër nga sa u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të lartcekurave, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur në këtë çështje kontestimore, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1012/19, datë 11.11.2021

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Arsim Hamzaj